

U ul miku im në xhami për të falur Namazin e Bajramit, filloi të flasë me veten e vet, filloi të llogarisë dhe pyes veten. Meditonte mbi muajin e fundit. . . i cili i kaloi si një ditë. . . U ul, duke ndjerë dhimbje, duke u pikëlluar për këto ditë dhe netë të cilat shkuan shumë shpejtë. Ajo që ia shtoi mërzinë dhe pikëllimin ishte se ai filloi të krahasojë veten me disa persona të cilët ishin ulur rreth tij. . . Dallimi mes atij dhe të tjerëve përreth ishte shumë i madh. . . Atëbotë kishin filluar garën në punë të mira në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë dhe çast, por ky ishte ngadalësuar apo edhe frenuar, derisa e kishin lënë shumë pas. . . Dëshironte t'i arrinte, por nuk mundte, dëshironte t'i shikoj, së paku me sy, por edhe kjo nuk ishte e mundur. . . Kishin shkuar shumë larg dhe kishin fituar shumë shpërblime. . .

Filloi të mendojë dhe të shfletojë faqet e veprave të mira për këtë muaj i cili i kaloi sa hap e mbyll sytë, ndoshta do të gjente në këto faqe gjëra që do t'ia ngrisin ambiciet këtij shpirti të pikëlluar. Hapi faqen e Kur'anit dhe në të nuk gjeti asgjë pos një hatmeje të cilën nuk kishte arritur ta kryej vetëmse me shumë vështirësi e mundime! Ndërsa ai dëgjon lajme, jo nga të parët tanë, por nga personat të cilët gjenden përreth tij, të cilët kanë arritur të bëjnë nga pesë, gjashtë, bile edhe nga dhjetë hatme. . .

U mundua të lehtësojë pikëllimin dhe mërzinë me hapjen e faqes së bujarisë dhe dhënies së lëmshës (sadasë).

Për ata të varfër që janë rreth tij apo jasht shtetit të tij prej muslimanëve të varfër veçanërisht ngase ai e din se All-llahu [subhanehu ve tealq] i ka dhënë pasuri. . . Vërejtje në fletën e tij se nuk kishte dhënë sa duhej të jipte, ngase ishte prej të pasurve, por mjaft dorështrënguar.

Lypësit dhe varfnjakët nuk patën pjesë në pasurinë e tij, pos një pjese mjaft të vogël! Disa persona sikur ky, miku im, edhe pse nuk kishin pasuri dhanë shumë sadaka.

E largoi shikim nga kjo fletë duke u mundua ta fshehë pikëllimin dhe dhimbjet, dhe shfletoi faqen tjetër,

ndoshta do ta gjente veten i pari në një sferë. Hapi faqen e ruajtjes së gjymtyrëve nga haramet, këtu u habit ngase iu kujtuan netët kur ua kishte lëshuar frerët gjymtyrëve, iu kujtuan ato takime ku mblidheshin me shokët për të shikuar programe të cilët i jipnin ata për të larguar nga rruga e Xhennetit, për të thirrë në rrugën e Xhehennemit, me ndihmën e programeve të kota, plot e përplot me filma të ndryshëm të fëlliqur, filmave serik, urimeve, humoreve. . . Turpërohet i mençuri, ejo besimtari i cili është i devotshëm dhe ka frikë All-llahun [subhanehu ve tealq] për të shikuar këtë jasht Ramazanit e jo në muajin e Ramazanit, në muajin e mëshirës.

Iu kujtuan mikut tim dhimbjet, pikëllimi dhe mërzia arritën kulminacionin. . . Sa shumë kohë ka humbur duke qëndruar para ekraneve televizive, duke shikuar lojërat shpërblyese që emitoheshin nëpër programet tona televizive. . . Kujtonte këto ditë dhe qante, qante për atë se ç'e kishte goditur, si kishte mundur t'ia lejojë vetes të humbë kohën në këto sende, ndërsa mundësia për të fituar në to është një me pesqindmijë, ndoshta edhe më shumë. . .

Përkujtonte ditët, njëherit edhe qortonte veten se si ishte dorëzuar nga ajo garë (me shokët e tij, në vepra të mira) në të cilën fitimi është i sigurt, fitimi është Xhenneti, arritja e kënaqësisë së All-llahut [subhanehu ve tealq], pemë të shijshme në Xhennetet përplot lumenj, bukuroshe të Xhennetit të cilat nuk i ka parë syri, nuk i ka prekë dorë njeriu, pa asnjëfarë të mete. . . Mundësitë për të fituar në këtë muaj janë të qindpërqindta për atë që është i sinqertë. . .

Duke qenë në xhami filloi të shikonte djathtas e majtas, i vërejtje disa shokë të veshur me veshje të mirë, gjithnjë duke qeshur pa masë, ndërsa nga ana tjetër i vërejtje disa të devotshëm dhe miq të All-llahut, të cilët ishin në saffet e para, vërente në fytyrat e tyre gëzim dhe hare. . . Sikur të mos ekzistonte frika nga All-llahu dhe sinqeriteti në vepra, do të thonin: „Ja pra, urdhëroni, lexoni librin tim!“.

Edhe këta ishin të veshur me rrobetë reja. . .

Këtu filluan të paraqiten pyetjet një pas një në mendjen e tij. . . Këto janë shokët e mi me të cilët e kalova këtë muaj në punë të kota prej të cilave nuk ka dobi, bile këto ditë i kalova edhe në punë të cilat All-llahu i ka bërë haram. . .

Për çka buzëqeshen këta, athua qeshen për shkuarjen e muajit të Ramazanit apo për veshjen e rrobave të reja, athua për ç'farë qeshen?!

Në këto momente iu kujtuan disa fjalë të cilët i kishte dëgjuar në hutben e Bajramit të kaluar, nga një hoxhë i nderuar, fjalë që pandalas i kalonin nëpër veshë: „Nuk është Bajram për atë person që ka veshur rroba të reja, Bajram është për atë person me të cilin është i kënaqur All-llahu i Lartësuar, dhe pastaj e ka liruar nga zjarri i Xhehennemit!“.

Për një cast iu kujtuar se ç'kishte lexuar në disa libra, se „të devotshmit gëzohen për Bajram, ngase All-llahu [subhanehu ve tealq] ua plotësoi mirësitë e tij me ardhjen dhe shkuarjen e Ramazanit, dhe shpresën se do t'ua pranoj All-llahu [subhanehu ve tealq] këtë muaj!“.

Pasi që miku im doli nga xhamia, i premtoi vetes premtime të sinqerta duke i thënë vetes: „Po të jem gjallë deri në Ramazanin tjetër, do ta shoh All-llahu [subhanehu ve tealq] se çka do të veproj! Do ta shijoj gëzimin dhe lumturinë të cilën e shijuan të devotshmit!“.

Këto, vëlla i dashur dhe motër e nderuar, janë ndjenja pendimi për zvarritjen e punëve, këto ndjenja u sollën në mendjen e tij me shpejtësi të madhe. . . Dhe ai ishte ulur në xhami për të falur namazin e Bajramit me muslimanët. Me siguri kjo është ndjenjë e çdo besimtari i cili në zemrën e tij ka ndjenja dhe di për vlerën e këtij muaji të shenjtë.

Shkuan ditët, muajt dhe erdh Ramazani dhe ky ju tregon juve bindjen dhe ambiciet për shfrytëzimin e këtij

muaji të shenjtë.

Atij iu shtuan ambiciet ngase ai vërejti se vdekja e kaploi njërin nga të afërmit e familjes së tij, dhe një tjetër nga lagjja e tij, pastaj shokun e tij të klasës me të cilin ishin ulur bashkë... E gjithë kjo e bëri që të falëndërojë All-llahun [subhanehu ve teala] që nuk ia kishte marrë shpirtin, por e kishte lënë edhe këtë herë të agjërojë muajin e shenjtë, duke u përmalluar shumë për këtë muaj.

Si të mos përmalohet kur ai dëgjon për vlerën e shumë të këtij muaji?! Vallë, a nuk është Ramazani muaj i Kur'anit, mëshirës, duasë (lutjes), pendimit, faljes, fitores...

Pse të mos përmalohet, kurse ai e dëgjon fjalën e të dashurit tonë Muhammedit [salall-llahu alejhi ve selem]: „Kush agjëron muajin e Ramazanit duke besuar dhe shpresuar në All-llahun [subhanehu ve teala] i falen të gjitha mëkatet!”

Pejgamberi [salall-llahu alejhi ve selem] thotë: „Kush i kalon natën e Ramazanit duke bërë ibadet (adhuruar All-llahun), duke qenë i bindur në besimin islam dhe duke shkresuar tek All-llahu, do t'i falen të gjitha mëkatet e tij të mëparshme!”

Njëherë tjetër Pejgamberi [salall-llahu alejhi ve selem] duke theksuar shpërblimet e mëdha të natës së Kadrit kishte thënë fjalë që kanë mbetur si shpresë për të gjithë njerëzit: „Kush falet natën e Kadrit, duke qenë i bindur në besimin islam dhe duke shkresuar tek All-llahu, do t'i falen të gjitha mëkatet e tij të mëparshme!”

Vallë, a qortohet ky person i cili është përmalluar shumë për këtë muaj, kurse e din se ai i cili i ka premtuar këto gjëra nuk është televizioni, radioja, gazeta, revista, por është Pejgamberi [salall-llahu alejhi ve selem]?!

Vallë, a qortohet ky person i cili është përmalluar shumë për këtë muaj, kurse ky e dëgjon fjalën e Pejgamberit [salall-llahu alejhi ve selem]: „Kur vjen

Ramazani, hapen dyert e Xhennetit, mbyllen dyert e Zjarrit dhe lidhen (prangosen) shejtanët (djajtë)”.

Mos e qortoni për këtë përmallim, ngase ai e di se dyert e Xhennetit nuk janë janë hapur dhe dyert e Xhennetit nuk janë mbyllur për melaqet, e as për kodrat, e as për drunjat e kafshët, por, e gjithë kjo është bërë për vëllezërit e tij besimtarë.

Mos e qortoni vëllezër, ngase ky e ka dëgjuar fjalën e Pejgamberit [salall-llahu alejhi ve selem]: „Kush lexon një shkronjë nga Kur'ani, për të do të shpërblehet me një të mirë, ndërsa një e mirë është sikur dhjetë të mira. Unë nuk them Elif, Lam, Mim është një shkronjë, por Elifi është shkronjë, Lami është shkronjë, Mimi është shkronjë”. Dhe e din se Kur'ani ka përafërsisht treqindmijë shkronja. Në një hatme ka mbi treqindmijë sevape (shpërblime)...

Lusim All-llahun [subhanehu ve teala], Zotin e botërave që të na mundëson ta shfrytëzojmë kohën në vepra të mira dhe të mos na bëj prej të pakujdesurve (neglizhentëve)! Amin!

Përktheu dhe përshtati: Abdyl Fuga

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com

